



**MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BURGJEVE**

Studim

Mbi trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve me burgim

Aspekte të jetës dhe trajtimit në IEVP

Punuan: Blerta Doçi & Ani Beqo

TIRANË, QERSHOR 2014

Përmbajtja

Kreu I Qëllimi i punimit, kuadri teorik dhe metodologjia e studimit.....	4
1.1 Hyrje mbi përmbajtjen dhe strukturën e punimit.....	4
1.2. Reforma në sistemin penitenciar në drejtim të respektimit të drejtat të njeriut dhe reduktimit të korrupsionit.....	5
1.2.1 Koncepti i reformës në sistemin penitenciar.....	5
1.2.2 Të Drejtat e Njeriut në sistemin e penitenciar.....	6
1.2.3 Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut në sistemin penitenciar.....	7
1.2.4 Qasje teorike mbi korrupsionin në sistemin e burgjeve.....	8
1.3 Metodologjia e studimit.....	9
1.3.1 Metoda e përdorur.....	9
1.3.2 Vlefshmëria e studimit.....	12
Kreu II Analizë e aspekteve të trajtimit të paraburgosurve dhe të dënuarve	13
2.1 Pritja në institucion.....	13
2.2 Deklarata të të burgosurve mbi aspekte të jetës në institucionet penitenciare.....	14
2.3 Përfshirja në aktivitete punësimi.....	15
2.4 Konsultimi dhe përgjegjësitë.....	16
2.4.1 Informimi nga stafi mbi vendime të praktikës së përditshme që ndikojnë te personat me liri të kufizuar.....	16
2.4.2 Ndërgjegjësimi i personave me liri të kufizuar mbi përgjegjësitë në institucion.....	17
2.5 Motivimi nga personeli.....	18
2.6 Etika e komunikimi të stafit.....	18
2.7 Korrupsioni.....	19
2.8 Vizitat në institucion.....	20
Kreu III. Konkluzione dhe rekomandime.....	21

Bibliografia.....	24
Aneksi 1 Pyetësor i përdorur me shtetasit në konflikt me ligjin.....	25

KREU I Qëllimi i punimit, kuadri teorik dhe metodologjia e studimit.

1.1 Hyrje mbi përmbajtjen dhe strukturën e punimit

Të drejtat e njeriut janë bërë një fushë e gjerë studimi në shkencën sociale, duke përfshirë studime analitike dhe empirike mbi të drejtën. Konteksti politik i studimit të të drejtave të njeriut në Shqipëri, lidhet me zhvillimet politike post-komuniste, marrëdhëniet ndërmjet shtetit dhe shtetasve, institucionet, demokratizmin dhe kondicionalitetet në kuadër të anëtarësimit në BE, procese këto të shoqëruara me një sërë reformash.

Respektimi i të drejtave të shtetasve me liri të kufizuar në sistemin penitenciar është një tregues i rëndësishëm se si shteti Shqiptar, ka adresuar një nga prioritetet më të rëndësishme në kuadër të angazhimeve për aderimin pranë strukturave Evropiane. Progres Raporti i Bashkimit Evropian, 2013, adresoi për sistemin penitenciar disa rekomandime për përmirësimin e respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar. Gjithashtu ky raport rekomandoi për Qeverisë Shqiptare, marrjen e masave për parandalimin e korrupsionit në vend.

Standardet për trajtimin e personave me liri të kufizuar, janë sanksionuar në disa norma dhe rregulla të Kombeve të Bashkuara¹ dhe BE-së. Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), e miratuar nga Kombet e Bashkuara në vitin 1948 u referohet shtyllave kryesore të sistemit të të drejtave të njeriut, të cilat janë liria, barazia dhe solidariteti. Po ashtu Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ratifikuar nga shteti Shqiptar, i referohet parimeve bazë të respektimit të të drejtave të njeriut ku rol të rëndësishëm luajnë të drejtat e personave me liri të kufizuar në sistemin penitenciar.

Aktualisht sistemi penitenciar është në një proces të rëndësishëm reformimi në aspektin strategjik, prandaj studimet janë me shumë rëndësi për evidentimin e problematikave dhe adresimin e prioriteteve, në përmbushje edhe të rekomandimeve të BE-së, në drejtim të përmirësimit të situatës së të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar dhe luftës kundër korrupsionit. Për këtë qëllim Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve ndërmori një studim për vlerësimin e trajtimit të personave në konflikt me ligjin, parë në këndvështrimin e

¹ Bassiouni Cherif, M., The protection of Human Rights in the Administration of Criminal Justice: A compendium of United Nations Norms and Standards, 1994, New York.

opinionëve të vetë të paraburgosurve dhe të dënuarve². Ky studim synon të prezantojë aspekte kryesore të jetesës, cilësisë së trajtimit dhe shërbimeve të ofruara, situatën e respektimit të të drejtave të shtetasve në konflikt me ligjin.

Studimi synon gjithashtu të masë nivelin e korrupsionit në administratën e sistemit penitenciar.

Mbështetur në rezultatet e këtij studimi propozohen disa alternativa për përmirësimin e reformës në sistemin penitenciar me qëllim përmirësimin e respektimit të të drejtave të shtetasve në konflikt me ligjin dhe ndërmarrjen e politikave të përshtatshme për parandalimin dhe minimizimin e fenomenit të korrupsionit.

1.2 Reforma në sistemin penitenciar në drejtim të respektimit të drejtave të njeriut dhe reduktimit të korrupsionit.

1.2.1 Koncepti i reformës në sistemin penitenciar.

Në literaturën bashkëkohore një përkufizim i përgjithshëm mbi ‘reformën në burgje’ i referohet një përpjekje për të përmirësuar filozofinë e menaxhimit të sistemit penitenciar, duke synuar në përgjithësi një sistem efektiv të drejtësisë penale dhe respektim të të drejtave të personave me liri të kufizuar.

Reformimi i sistemit penitenciar, daton nga fillimi i shekullit të XVIII, periudhë kur trajtimi çnjerëzor, tortura dhe ekzekutimet në funksion të ndëshkimit, filluan të konsideroheshin dhunim i të drejtave të njeriut. Për këtë arsye reformat synonin ndryshimin e konceptit të burgimit nga ndëshkimi, në rehabilitimin e të burgosurve³.

Që prej kësaj periudhe, lidhja ndërmjet reformave dhe respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar në institucionet penitenciare, ka qenë objekt kërkimesh të vazhdueshme për studiuesit.

² Pyetsori “Mbi trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në IEVP”, është përshtatur nga një grup pune në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, asistuar nga ekspertë të burgjeve të Holandës, në kuadër të projektit të Komitetit Shqiptar të Helsinkit “Për një trajtim më të mirë të personave me liri të kufizuar”, financuar nga OSI, Budapest.

³ The Howard League for Penal Reform

<http://www.howardleague.org/history-of-prison-system/>

Nëpërmjet analizës të situatës aktuale, ky studim përforcon rëndësinë e reformës në sistemin penitenciar shqiptar, për ndryshimin e mentalitetit dhe filozofisë së menaxhimit të sistemit, me qëllim forcimin e respektimit të të drejtave të njeriut dhe uljen e qëndrueshme dhe progresive të korrupsionit, përmbushjen e standardeve të duhura për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve dhe rehabilitimin e ri-integrimit të personave me liri të kufizuar.

1.2.2 Të Drejtat e Njeriut në sistemin e penitenciar

‘Të drejtat e njeriut’ janë të drejtat dhe liritë themelore që gëzojnë të gjithë njerëzit pavarësisht kombësisë, gjinisë, origjinës kombëtare apo etnike, racës, besimit, gjuhës apo ndonjë statusi tjetër⁴.

Sipas Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (UDHR), të drejtat e njeriut garantojnë barazi, siç është mbrojtja e barabartë kundër të gjitha formave të diskriminimit për të gëzuar të gjitha të drejtat e njeriut. “Të gjithë njerëzit lindin të lirë dhe të barabartë në pikëpamje të dinjitetit dhe të të drejtave.”⁵ Të drejtat e njeriut nuk mund të përdoren për shkeljen e të drejtave njerëzore të të tjerëve. Edhe pse në situatën e personave me liri të kufizuar vihen disa kufizime, ato duhet të vihen në frymën e të drejtave të njeriut⁶.

Çfarë e kushtëzon vëmendjen tonë ndaj respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar që në një farë mënyrë kanë çenuar sigurinë shoqërore? Detyrimi për respektimin e të drejtave të të burgosurve mbështetet në dy faktorë: Së pari aspekti human, që lidhet me të drejtat e njeriut. Sipas nenit 3 të Konventës për të Drejtat e Njeriut: “Askush nuk mund t’i nënshtrohet torturës ose keqtrajtimit”⁷. Pra, dinjiteti njerëzor duhet të respektohet edhe në burg; së dyti aspekti pragmatist, që lidhet me kthimin e këtyre individëve nga subjekte të krimit në individë me parime morale dhe të qytetarisë, të aftë për t’u ri-përfshirë në shoqëri dhe për t’iu shkëputur jetës kriminale.

⁴ "Amnesty Basic Definition of Human Rights", Amnesty International.
<http://www.amnestyusa.org/research/human-rights-basics>. Retrieved 19 June 2011.

⁵ Universal Declaration of Human Rights, neni 1

⁶ Po aty, neni 30

<http://www.un.org/events/humanrights/2007/hrphotos/declaration%20eng.pdf>

⁷ Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore ndryshuar me Protokollin Nr. 11, shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13

http://juridiku.weebly.com/uploads/3/1/5/2/3152521/konventa_evropiane_e_drejtave_t_njeriut.pdf

Njohja dhe informimi i vazhdueshëm i personave me liri të kufizuar mbi të drejtat e tyre, nga personeli i sistemit penitenciar, është një obligim që rrjedh nga standardet ndërkombëtare dhe që garantohet nga legjislacioni vendas. Rezoluta 49/184 e Asamblesë së Përgjithshme të OKB-së e 23 Dhjetorit 1994, thekson: “Informimi mbi të drejtat e njeriut duhet të jetë proces i përhershëm dhe gjithëpërfshirës në të cilin njerëzit e të gjitha niveleve të zhvillimit dhe shtresave të shoqërisë mësojnë për respektin ndaj dinjitetit të të tjerëve, si dhe për mjetet dhe metodat e sigurimit të atij respekti në të gjitha shoqëritë”.

Rezultatet e këtij studimi do të tregojnë se nevojiten masa konkrete për të rritur ndërgjegjësimin e administratës së sistemit penitenciar, mbi rëndësinë e informimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve për të drejtat e tyre në institucionet penale, pasi ky proces jo gjithmonë kryhet në mënyrë të rregullt dhe të vazhdueshme.

1.2.3 Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut në sistemin penitenciar

Korrupsioni është një fenomen kompleks, po aq sa është i vjetër. Termi korrupsion rrjedh nga fjala latinishte “*corruption*”, që nënkupton “*degradim moral*”. Koncepti mbi korrupsionit përgjithësisht ndryshon sipas kontekstit, prandaj është e vështirë të përcaktohet një term i vetëm bashkëkohor, për shkak të dimensioneve të shumta të tij. Zakonisht në kontekstin publik, korrupsioni përkufizohet si një akt antiligjor, që lidhet me abuzimin e pushtetit dhe besimit publik, për përfitime personale. Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) e lidh korrupsionin me korrelacionin ndërmjet koncepteve të tilla si pushteti, përgjegjshmëria, liria e veprimit, integriteti dhe transparenca⁸.

Korrupsioni është një problem universal që afekton funksionimin e administratës publike dhe të drejtat e grupeve më vulnerabël të shoqërisë, në veçanti të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke përforcuar përjashtimin, diskriminimin dhe arbitraritetin. Ekzistojnë tre koncepte që trajtojnë mënyrën si korrupsioni afekton të drejtave të njeriut: korrupsioni i drejtpërdrejtë, jo i drejtpërdrejtë dhe me ndikim të

⁸ United Nations Development Program (2004), Anti-Corruption Practice Note, UNDP
http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf

largët⁹. Në rastin e sistemit penitenciar mund të themi se dy janë format kryesore të ndikimit të korrupsionit në të drejtat e personave me liri të kufizuar: ndikimi i drejtpërdrejtë dhe ndikimi jo i drejtpërdrejtë. Korrupsioni me ndikim të drejtpërdrejtë, afekton të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke cënuar parimin e barazisë, paanshmërisë dhe mosdiskriminimit dhe duke privuar aksesin e tyre në këto të drejta, p.sh. një ryshfet i dhënë kundrejt një favoriti siç mund të jetë ndryshimi i dhomës, përfitimi i trajtimit mjekësor apo përfitimi i një leje të veçantë. Korrupsioni me ndikim jo të drejtpërdrejtë, po ashtu ka ndikim në të drejtat e personave me liri të kufizuar kur ekziston një kusht për cënimin e të drejtave të kësaj kategorie. Një rast mund të jetë p.sh. korrupsioni në tendera, që ndikon në të drejtën e kategorisë së personave me liri të kufizuar për të përfituar shërbime cilësore dhe sipas standardeve. Në këtë studim i jemi referuar korrupsionit me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e personave me liri të kufizuar.

1.2.4 Qasje teorike mbi korrupsionin në sistemin e burgjeve

Qasjet teorike bashkëkohore mbi korrupsionin me ndikim të drejtpërdrejtë në të drejtat e personave me liri të kufizuar në sistemin penitenciar, mbështeten në dy aspekte kryesore organizative. Sipas studiuesit Herman Golstein¹⁰, këto qasje përpiqen të shpjegojnë arsyet e lindjes së korrupsionit në sistemin penitenciar.

Rregullat e organizimit

Kjo qasje ka të bëjë me faktin se si janë përcaktuar, komunikuar dhe kuptuar, rregullat e organizimit dhe të funksionimit të institucionit, nga administrata e burgut. Këto rregulla përcaktojnë ndër të tjera edhe aspekte të tilla të sjelljes, si: pranimi i dhuratave të vogla, vakteve të ushqimit apo favoreve të tjera.

⁹ Adugna Gebeye, B.: Corruption and Human Rights: Exploring the Relationships, 2012, f.9 .
<http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2012/70-gebeye-2012.pdf>

¹⁰ U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice “The Measurement of Police Integrity”
<file:///C:/Users/User/Desktop/Prison%20corruption.pdf>

Mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit

Një dimension i dytë i lidhur me korrupsionin në sistemin penitenciar, ka të bëjë me mekanizmat për parandalimin dhe kontrollin. Mekanizma të rëndësishme të parandalimit dhe kontrollit janë: edukimi dhe trajnimi mbi etikën, si dhe monitorimi dhe hetimi proaktiv e reagues i akteve korruptive¹¹. Sipas kësaj qasje niveli i zbatimit të këtyre mekanizmave, ndikon ndjeshëm në nivelin e korrupsionit.

Sipas studiuësve ekziston edhe një dimension i tretë i korrupsionit në sistemin penitenciar, që ka të bëjë me ndikimin e faktorëve social, ekonomikë, politikë në të cilat funksionon sistemi në tërësi. Sipas kësaj qasje, pritshmëritë e publikut mbi sjelljen dhe integritetin e punonjësve të sistemit penitenciar, luajnë rol në performancën e tyre. Besohet se në vendet ku ka presion të lartë të publikut kundër akteve korruptive, performanca e punonjësve të sistemit penitenciar është më pozitive, krahasuar me vendet ku presioni është i ulët.

Nisur nga konteksti i sistemit tonë penitenciar, përbëjnë rëndësi studimi dy qasjet kryesore mbi: *Rregullat e organizimit dhe Mekanizmat e parandalimit dhe kontrollit*.

1.3 Metodologjia e studimit

1.3.1 Metoda e përdorur

Metoda e përdorur në këtë studim mbështetet kryesisht në punën kërkimore në terren. Puna kërkimore në terren ka konsistuar: së pari në grumbullimin e të dhënave mbi vendndodhjen e institucioneve penitenciare dhe të dhëna statistikore mbi kapacitetin dhe kategoritë e akomoduarra në këto institucione. Këto të dhëna janë mbledhur nga burime institucionale¹²; së dyti, në zhvillimin e pyetësorëve me personat me liri të kufizuar në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale.

Gjithashtu janë kryer hulumtime në literaturën vendase dhe të huaj, për sa i përket studimeve aktuale mbi çështje të lidhura me reformën, të drejtat e njeriut dhe fenomenin e

¹¹ Hetimi reaktiv ka të bëjë me reagim/ kundërpërgjigje pas kryerjes së aktit (korruptiv), ndërkohë hetimi pro-aktiv ka të bëjë me kundërpërgjigje përpara kryerjes së aktit (korruptiv), për ta parandaluar atë.

¹² Sektori i Raportimit, Statistikave dhe Kartotekës në Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

korrupsionit në sistemin penitenciar, si dhe dokumentat ndërkombëtarë që përcaktojnë standardet e respektimit të drejtave të njeriut në sistemin penitenciar.

Pyetësi ishte i vetë administrueshëm dhe kërkonte mesatarisht 15 minuta kohë për plotësimin e tij. Në rastet kur të paraburgosurit/të dënuarit hasnin vështirësi për të kuptuar çështjet e pyetësorit ata u ndihmuan përmes intervistimit. Përpara plotësimit pjesëmarrësve u dhanë sqarimet e duhura mbi qëllimin e punimit dhe konfidencialitetin e të dhënave identifikuese. Të paraburgosurve / të dënuarve që pranuan vullnetarisht të kontribuojnë për realizimin e punimit, u siguroa konfidencialiteti dhe anonimiteti i plotë.

Gjatë procesit u kontaktua me stafin e institucioneve në fjalë, të cilët dhanë një kontribut të konsiderueshëm përmes ofrimit të të dhënave mbi punën e zhvilluar në këto institucione.


Kampioni i studimit u përzgjedh nga 15 IEVP dhe përbëhet nga 566 të paraburgosur dhe të dënuar. Përzgjedhja e të anketuarve është bërë mbështetur në disa tregues, si: gjinia, grup-mosha dhe gjendja gjyqësore, të përshkruara në tabelën vijuese.

<i>Nr.</i>	<i>I.E.V.P</i>	<i>Kategoria</i>	<i>Nr. /sipas kategorive</i>	<i>Statusi</i>	<i>Total</i>
1.	A.Demi	Gra	20	Të dënuar	35
		Të rritur	15		
2.	M.Peza	Të rritur	30	Të p/burgosur	30
3.	J.Misja	Të rritur	20	Të p/burgosur	50
		Të mitur	10		
		Gra	20		
4.	Vaqarr	Të rritur	30	Të dënuar	30
5.	Fushë-Krujë	Të rritur	35	Të dënuar	35
6.	Kavajë	Të mitur	15	Të dënuar	25
			10	Të p/burgosur	
7.	Lezhë	Të rritur	40	Të dënuar	45
		Të mitur	5	Të p/burgosur	
8.	Durrës	Të rritur	31	Të p/burgosur	31
9.	Elbasan	Të rritur	40	Të p/burgosur	40
10.	Rrogozhinë	Të rritur	35	Të p/burgosur	35
11.	Peqin	Të rritur	50	Të dënuar	50
12.	Vlorë	Të rritur	35	Të p/burgosur	50

		Të mitur	15		
13.	Lushnje	Të rritur	35	Të dënuar	35
14.	Tepelenë	Të rritur	35	Të dënuar	35
15.	Burrel	Të rritur	40	Të dënuar	40


Tab.1 Shpërndarja e kampionit, sipas IEVP

Ndarja e të anketuarve sipas grup-moshës ishte: 9.8% e të anketuarve të mitur dhe 90.2% të rritur.




Grafik 1

Ndarja e të anketuarve sipas gjinisë ishte: 7% e të anketuarve femra dhe 93% meshkuj.



Grafik 2

Ndarja e të anketuarve sipas gjendjes gjyqësore ishte: 44.3% e të anketuarve të paraburgosur dhe 55.7% të dënuar.



Grafik 3

1.3.2 Vlefshmëria e studimit

Gjatë zhvillimit të studimit jemi përpjekur të marrim në konsideratë elementët që përforcojnë dhe dobësojnë vlefshmërinë e studimit. Këto elementë gjenden të shpërndarë në tre faza kryesore të punimit, si vijon.

a. Faza e planifikimit të kërkimit

- sigurimi i burimeve të përshtatshme logjistike dhe njerëzore për kryerjen e studimit;
- zgjedhja e një periudhe kohore të duhur;
- përzgjedhje kampioni të përshtatshëm;
- përzgjedhja e metodologjisë së përshtatshme;
- instrumente të përshtatshme për mbledhjen e të dhënave;
- koordinimi dhe operacionalizimi i duhur.

b. Faza e mbledhjes të të dhënave:

- kushtet fizike për administrimin e instrumentit matës (mungesa ambientit të përshtatshëm, mbledhja e të dhënave në vende ku mund të ushtrojnë ndikim bashkëvuajtësit e tjerë ose stafi);
- vetëdijësimi i të qenit subjekt i studimit mund të ndikojë në dhënien e informacionin (efekti Hawthorn);
- kushtet psikologjike të subjektit, i cili administron instrumentin;
- sigurimi i procedurave të standardizuara;

- respektimi i çështjeve etike dhe konfidencialitetit.

c. Faza e analizës të të dhënave

- trajtimi i duhur statistikor;
- interpretimi objektiv i të dhënave;
- ndarja e opinionit nga fakti;
- njohja e korrelacioneve dhe faktorëve që ndikojnë të dhënat.

Kapitulli II. Analizë e aspekteve të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve

2.1 Pritja në IEVP

Siç përmendëm më lart, njohja e të dënuarve dhe të paraburgosurve me të drejtat dhe mekanizmat për mbrojtjen e tyre, është një proces i rëndësishëm për vetëdijësimin dhe rritjen e përgjegjshmërisë së kësaj kategorie për të drejtat e tyre. Informimi i të paraburgosurve dhe të dënuarve për të drejtat e tyre, duhet të bëhet që në momentin e pranimin të tij në një institucion penitenciar dhe zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë qëndrimit të tij në institucion. Por, mbështetur në të dhënat e studimit rezulton se vetëm 62% e të anketuarve pranojnë të jenë informuar mbi të drejtat e tyre nga administrata, në momentin e pranimin në institucion. Ndërkohë për sa i përket aspekteve të tjera gjatë pranimin, të dhënat e studimit tregojnë se 66.1% e të anketuarve pranojnë t'iu jenë krijuar mundësitë për të kontaktuar familjarët e tyre në momentin e pranimin në institucion dhe 47.1% e të anketuar pranojnë t'iu jenë krijuar mundësitë për të zgjedhur se me kë mund të ndajnë dhomën.

Nga rezultatet konstatohet se 38% e të anketuarve nuk janë informuar për të drejtat e tyre në momentin e pranimin në institucion. Po ashtu e drejta për të njoftuar familjarët konstatohet se nuk respektohet në të gjithë rastet. Mospnjohja e të drejtave të tyre nga personat me liri të kufizuar, dhe e detyrimit që administrata e sistemit penitenciar ka për t'ua ofruar atyre këtë informacion, fillimisht me pranimin në institucion dhe vazhdimisht gjatë qëndrimit të tyre në IEVP, mund të çojë në raste abuzivizmi me autoritetin nga stafi i sistemit penitenciar dhe në akte konkrete korrupsioni. Si rezultat nevojitet zbatimi i mekanizmave të parandalimit, si edukimi dhe trajnimi i vazhdueshëm i personelit në çështje të komunikimit, respektimit të të drejtave të personave me liri të kufizuar dhe mbi

rëndësinë e informimit të kësaj kategorie për të drejtat që ata i gëzojnë me ligj. Gjithashtu monitorimi i vazhdueshëm është një mekanizëm tjetër i rëndësishëm, për evidentimit e rasteve të abuzimit me të drejtat e personave me liri të kufizuar dhe akteve korruptive, si dhe mënyrën si adresohen ato për hetim të mëtejshëm nga organet kompetente.


2.2 Deklarata të të burgosurve mbi aspekte të jetës në institucionet penitenciare.

Të anketuarit u pyetën mbi aspekte të tjera të rëndësishme të jetës në institucion. Pyetjes nëse kanë një punonjës kontakti për të adresuar çështjet të ndryshme të jetës në institucion: 89.7 % e të anketuar u përgjigjën se janë shumë dakord ose dakord me këtë pohim, 6.6% e të anketuarve janë shprehur kundër dhe 3.7% janë shprehur as po as jo. Pyetjes nëse punonjësit (të rolit bazë, punonjës social/edukator/ psikolog), i njohin kushtet dhe rrethanat e tyre: 90.8% e të anketuarve iu përgjigjën shumë dakord ose dakord, 2.6% janë shprehur shumë kundër ose kundër dhe 6.6% as po as jo. Pyetjes nëse do t'i besonin punonjësit (të rolit bazë, punonjës social/edukator/psikolog), në rast krize, 78% iu përgjigjën shumë dakord ose dakord, 4.5 % janë shprehur shumë kundër ose kundër, dhe 8.6 % as po as jo. Pyetjes nëse personeli dëgjon dhe shqyrton sugjerimet dhe ankesat e tyre, 84.5% e të anketuarve iu përgjigjën shumë dakord ose dakord, 6.4% iu përgjigjën shumë kundër ose kundër dhe 9.1% as po as jo. Pyetjes nëse pjesa më e madhe e punonjësve i kontaktojnë gjatë orëve të shërbimit, 87% e të anketuarve u përgjigjën shumë dakord ose dakord, 4.5 % e tyre u përgjigjën kundër apo shumë kundër dhe 8.3% as po as jo. Pyetjes nëse iu është ofruar informacion se si mund të marrin ndihmë profesionale (avokat, mjek, psikolog), 78.8% e të anketuarve iu përgjigjën shumë dakord ose dakord, 11% iu përgjigjën kundër apo shumë kundër dhe 10.2% as po as jo. Pyetjes nëse mënyra e shërbimit të vakteve ushqimore është e përshtatshme dhe e respektueshme, 69.8% iu përgjigjën dakord ose shumë dakord, 18.5% iu përgjigjën kundër apo shumë kundër, dhe 12.5% as po as jo. Pyetjes nëse rregulli në qeli nuk çënohet nga kontrolli rutinë i sigurisë, 65.2% iu përgjigjën shumë dakord ose dakord, 21.9% iu përgjigjën kundër apo shumë kundër dhe 12.7% as po as jo.

Në rastet e përzgjedhjes së opsionit “*as po as jo*”, të anketuarit nuk janë të bindur për opinionin e tyre, kjo supozohet nga fakti se mund të kenë përjetuar eksperiencë pozitive dhe negative në raport me marrëdhëniet me personelin.

2.3 Përfshirja në aktivitet pune apo programe të tjera.

Lidhur me përfshirjen në aktivitete pune apo programe të tjera, 51.9% e të anketuarve pohuan se u janë krijuar mundësitë për t’u përfshirë në aktivitete punësimi apo programe të tjera të organizuara në institucion, 45.9% e të anketuar iu përgjigjën se nuk u janë krijuar mundësitë për t’u përfshirë në aktivitete pune apo aktivitete të tjera dhe 2.2% nuk kanë pranuar të përgjigjen, pa dhënë shpjegime.




Grafiku 4

Në kushtet kur prej disa vitesh mbipopullimi është shqetësim për sistemin penitenciar, paralelisht me hartimin e politikave të përshtatshme për uljen e mbipopullimit, nevojitet sigurimi i burimeve të mjaftueshme për shtimin e aktiviteteve rehabilituese dhe veprimtarive prodhuese për personat me liri të kufizuar, si dhe përshtatje e orarit të aktiviteteve, me qëllim uljen aq sa dhe ku është e mundur të kohëqëndrimit të tyre brenda qelisë.

2.4 Konsultimi dhe përgjegjësitë

2.4.1 Informimi nga stafi mbi vendime të praktikës së përditshme që ndikojnë te personat me liri të kufizuar.


Informimi në mënyrë të vazhdueshme nga personeli mbi përgjegjësitë e të dënuarve/të paraburgosurve lidhur me aspekte të ndryshme të jetës në institucion, është një komponent i rëndësishëm që ndikon në krijimin e klimës së sigurisë në institucion. Pyetjes se sa informohen ata në mënyrë të vazhdueshme mbi aspekte apo vendime të jetës së përditshme, 48% e të anketuarve u përgjigjën gjithmonë, 27% thujse gjithmonë, 16% ndonjëherë dhe 9% rrallëherë apo asnjëherë.



Grafiku 5

2.4.2 Ndërgjegjësimi i personave me liri të kufizuar mbi përgjegjësitë në institucion.

Lidhur me faktin se sa ndihen të anketuarit me përgjegjësi për aspektet e ndryshme të jetës të përditshme në institucion, rezulton se: 65% ndihen në një shkallë të konsiderueshme përgjegjës, 31% ndihen në një shkallë të vogël dhe 4% nuk ndihen aspak përgjegjës.




Grafiku 6

Referuar të dhënave në përqindje, duhet më tepër angazhim i stafit dhe trajnim i tij në teknika specifike për informimin e vazhdueshëm, rritjen e ndërgjegjësimit dhe vetëdijësimit të paraburgosurve dhe të dënuarve, për përgjegjësitë e tyre mbi aspekte të ndryshme të jetës të përditshme në institucion. Kjo gjë do të ndikonte në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe rritjen e sigurisë në institucion.

2.5 Motivimi nga personeli

Pyetjes se sa pranohen arritjet/sukseset e të paraburgosurve/dënuarve në përgjithësi dhe a vihen në pah ato nga personeli i institucionit, 46% e të anketuarve i janë përgjigjur se shpesh pranohen arritjet e tyre dhe vihen në pah nga personeli, 37% e të anketuarve janë përgjigjur ndonjëherë, 10% janë përgjigjur rrallëherë dhe 7% asnjëherë.




Grafiku 7

Motivimi është një komponent shumë i rëndësishëm në punën me të paraburgosurit dhe të dënuarit, sidomos në krijimin e një klime besueshmërie dhe reciprociteti. Motivimi i personave me liri të kufizuar mund të behët nga një staf që vlerëson rëndësinë e motivimit dhe njeh teknikat e motivimit. Prandaj edhe në këtë aspekt trajnimi i stafit të niveleve të ndryshme drejtuese merr rëndësi të veçantë për mbarëvajtjen e institucionit në tërësi.

2.6 Etika e komunikimit dhe sjelljes të stafit

Pyetjes se sa shpesh personeli i institucionit u drejtohet të paraburgosurve/dënuarve me të bërtitura dhe /ose në mënyra apo veprime që ju duken fyese apo përcmuese, 59% e të anketuarve janë përgjigjur gjithmonë, 16% janë përgjigjur shpesh, 13% janë përgjigjur ndonjëherë, 6% janë përgjigjur në raste të rralla dhe 6% i janë përgjigjur asnjëherë.




Grafiku 8

Tabloja do të ishte më e qartë nëse një pyetësor do të ishte zhvilluar ne punonjësit për të matur njohjen nga ana e tyre të koncepteve dhe rregullave të etikës së sjelljes dhe komunikimit, si i interpretojnë ata këto rregulla, sa i zbatojnë ato në punën e tyre të përditshme dhe sa i njohin ata pasojat në rast të mosrespektimit të këtyre rregullave. Rezultatet e këtij studimi tregojnë se çështjet e etikës së komunikimit dhe sjelljes duhen studiuar më tej, për shkak edhe të pasojave që mund sjellin në aspekte të tjera të funksionimit të sistemit penitenciar në tërësi. Në një studim të kryer në SHBA, në vitin 1972 mbi raportin ndërmjet sjelljeve jo etike dhe korrupsionit, u konstatua një korrelacion

pothuaj në të gjithë nivelet e punonjësve të sistemit penitenciar, të motivuara nga lakmia dhe interesi personal¹³.

2.7 Korrupsioni

Të anketuarit u pyetën nëse janë ndjerë nën presion për të dhënë *para* në këmbim të përfitimeve. 88% e të anketuarve kanë mohuar të kenë dhënë para kundrejt një favorit/përfitimi, 8% kanë pohuar të kenë dhënë para kundrejt një përfitimi/favorit dhe 4% nuk kanë pranuar t'i përgjigjen kësaj pyetje, pa dhënë shpjegime.



Grafiku 9

Ndarja e opinionit nga fakti është e vështirë të bëhet në mënyrë objektive, megjithatë duhen marrë në konsideratë mundësitë për spekulime për motive personale apo arsye të tjera subjektive. Me fakte jo të provuara dhe pa pasur mundësi të ndajmë opinionin nga fakti, deklaratat e të dënuarve dhe të paraburgosurve, ndonëse me një përqindje shumë të vogël krahasuar me kampionin e anketuar, tregojnë se korrupsioni mund të cënojë performancën e sistemit penitenciar, prandaj hapa konkrete duhen ndërmarrë për parandalimin e plotë të tij.

2.8 Vizitat në institucion

¹³ Worley R., & Barua, V. (2009). Criminal Justice ethics. In J. Miller (Ed.). 21st Century criminology: A reference handbook. (pp 861-871). Thousand Oaks: Sage Publications, Inc. doi:10.4135/9781412971997.n98 http://www.sagepub.com/haganintocrim8e/study/chapter/handbooks/42347_2.1.pdf

Krijimi i aksesit dhe kushteve të duhura për zhvillimin e vizitave dhe takimet në institucion të personave me liri të kufizuar me të afërmit e tyre, është një nga aspektet më të drejtave të kësaj kategorie. Deklarata e të anketuarve mbi aksesin në vizita dhe trajtimin e vizitorëve, jep një panoramë sipas kësaj tablele.

Deklarata për trajtim pozitiv	Shumë dakord	Dakord	Asnjërin	Kundër	Shumë kundër
Sistemi i planifikimit të vizitave mund të përdoret me lehtësi (vendos vetë i dënuari për datat)	60,2%	30,3%	2,5%	3,5%	3,4%
Vizitorët mund të presin në rehati dhe intimitet të arsyeshëm	41,6%	36,9%	3,3%	16,3%	1,9% 1,9%
Vizitorët e mi trajtohen me dinjitet gjatë kohës së takimeve	45,7%	30,9%	13,6%	5,6%	4,2%
Oficerët e burgut janë të ndjeshëm ndaj tensioneve/stresit të mundshëm gjatë vizitave për të burgosurin	37,5%	42,6%	8,5%	7,3%	4,1%
Deklarata për trajtime negative të vizitave	Shumë dakord	Dakord	Asnjërin	Kundër	Shumë kundër
Masat e sigurisë çënojnë intimitetin në mënyrë të panevojshme	12,1%	13,4%	18,3%	26,7%	29,5%
Vizitorët e mi shprehin ankesa për ngacmime seksuale gjatë vizitave, nga personeli i burgut.	4,6%	2%	11,6%	23,7%	58,1%

Tab.2 Deklaratat mbi vizitat në institucion

Rezultatet tregojnë se nevojiten masa konkrete për krijimin e një klime miqësore për pritjen dhe gjatë takimeve të personave me liri të kufizuar me familjarët e tyre. Trajnimi i stafit mbi teknikat e komunikimit me familjarët e personave me liri të kufizuar, gjatë pritjes dhe shoqërimit për takimet, do të përmirësonte imazhin e institucionit dhe pritshmëritë e familjarëve për mënyrën si trajtohen të paraburgosurit dhe të dënuarit në IEVP. Gjithashtu zhvillimi i teknologjisë së vëzhgimit, nëpërmjet kamerave, do të bënte të mundur verifikimin e çdo pretendimi nga ana e personave me liri të kufizuar, për trajtim jo etik nga stafi i sistemit penitenciar të familjarëve të tyre.

Kapitulli III. Konkluzione dhe rekomandime

Ky studim tregoi se përmirësimi i shërbimeve dhe parandalimi i akteve korruptive mbeten prioritete për sistemin tonë penitenciar, për t'u adresuar me strategji dhe plane veprimi konkrete.

Sigurimi i burimeve të mjaftueshme materiale dhe financiare, bashkëpunimi me OJF dhe komunitetin e biznesit, për shtimin e aktiviteteve rehabilituese dhe veprimtarive prodhuese për personat me liri të kufizuar, si dhe përshtatja e orarit të aktiviteteve, me qëllim uljen aq sa dhe ku është e mundur të kohëqëndrimit të tyre brenda qelisë, do të përmirësonte standardet e trajtimit të kësaj kategorie, duke bërë të mundur lehtësimin e procesit të rehabilitimit.

Për reduktimin e akteve korruptive në administratën e sistemit penitenciar, nevojitet angazhim i mëtjshëm për forcimin e reformës në drejtim të: rritjes së efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së sistemit penitenciar; rritjes së integritetit të institucioneve dhe promovimit të vlerave të drejtimit të mirë; zbatimit efektiv dhe të barabartë të ligjit; përmirësimit të transparencës dhe aksesit në informacion.

Në aspektin e organizimit institucional, për parandalimin e korrupsionit, nevojitet hartimi i rregullave të formuluar qartë, komunikimi i tyre dhe të treguarit të kuptueshmërisë për këto rregulla, si nga personeli ashtu edhe nga të paraburgosurit dhe të dënuarit.

Gjithashtu nevojitet zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshme dhe standarde të parandalimit dhe kontrollit, nëpërmjet zbatimit të rregullt të planeve vjetore të inspektimit të IEVP-ve, shqyrtimit të gjithë deklaratave për korrupsion të të paraburgosurve dhe të dënuarve dhe adresimit për ndjekje dhe hetim penal të rasteve të korrupsionit.

Zhvillimi profesional i vazhdueshëm dhe i qëndrueshëm i stafit të sistemit penitenciar, veçanërisht trajnimi mbi rëndësinë e informimit dhe vetëdijësimit të personave me liri të kufizuar për të drejtat e tyre dhe mbi etikën e sjelljes dhe të komunikimit të personelit, është një proces i rëndësishëm për parandalimin e akteve të abuzivizmit me autoritetin dhe korrupsionit, ndërsa fuqizon dhe rrit përgjegjshmërinë e kësaj kategorie për të drejtat e tyre.

Prioritare mbetet gjithashtu zhvillimi i mekanizmave të qëndrueshëm për matjen e korrupsionit në sistemin penitenciar, të tilla si: kryerja e studimeve të paanshme dhe të pavarura, duke përdorur instrumenta profesional, për *identifikimin e risqeve* për kryerjen e akteve korruptive në sistemin penitenciar, në mënyrë që të identifikohen fushat prioritare për reformim.

Krijimi i një sistemi database të dhënash statistikore mbi rastet korruptive, krijon lehtësira për kryerjen e vlerësimeve konkrete dhe të matshme mbi korrupsionin, si dhe shërbejnë për të parë trendin në kohë dhe efektivitetin e reformave të ndërmarra në reduktimin e këtij fenomeni.

Në lidhje me modelet alternative që mund të ndiqen për konsolidimin e mëtejshëm të të drejtave të të burgosurve, nevojiten studime dhe vlerësime nga ekspertë të fushës mbi ndikimin e privatizimit të burgjeve apo shërbimeve specifike private, në përmirësimin e trajtimit të personave me liri të kufizuar në sistemit tonë penitenciar dhe reduktimin e akteve korruptive. Duke qenë se sektori privat bën të mundur sigurimin e burimeve në mënyrë të shpejtë dhe fleksibël, kemi të drejtën të besojmë se privatizimi i burgjeve apo shërbimeve specifike, do të sigurojë një kontribut të vlefshëm në rritjen e inovacionit dhe efikasitetit, përmirësimin e kushteve të jetesës dhe trajtimit të personave me liri të kufizuar dhe minimizimin e korrupsionit, në sistemin penitenciar. Diskursi mbi politikën e privatizimit të sistemit penitenciar ka sjellë debate në radhët e politikëbërësve dhe grupeve të interesit, megjithëse ky proces duhet kuptuar si një proces i përditshëm i administrimit publik. E gjithë kjo është një sfidë e realizueshme, në funksion të ndryshimit të filozofisë politike për reformën në sistemin penitenciar, po ashtu një zhvillim i rëndësishëm për ekonominë kombëtare, që kërkon ndryshim në strukturën e taksave. Implementimi i këtij procesi, nëse jo i plotë së paku i pilotuar në disa shërbimeve specifike, do të bënte të mundur vlerësimin e efektivitetit të shërbimeve private në sistemin penitenciar, në drejtim të përmirësimit të shërbimeve, respektimit të drejtave të personave me liri të kufizuar dhe reduktimit të akteve korruptive, që çënojnë çdo aspekt të funksionimit normal të sistemit penitenciar.

Bibliografia

"Amnesty Basic Definition of Human Rights", Amnesty International
<http://www.amnestyusa.org/research/human-rights-basics>. Retrieved 19 June 2011

The Howard League for Penal Reform
<http://www.howardleague.org/history-of-prison-system/>

Universal Declaration of Human Rights, article 1, 30
<http://www.un.org/events/humanrights/2007/hrphotos/declaration%20eng.pdf>

Konventa për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive themelore ndryshuar me Protokollin Nr. 11, shoqëruar nga Protokollet Nr. 1, 4, 6, 7, 12 e 13
http://juridiku.weebly.com/uploads/3/1/5/2/3152521/konventa_evropiane_e_drejtave_t_nj_eriut.pdf

United Nations Development Program (2004), Anti-Corruption Practice Note, UNDP
http://www.undp.org/governance/docs/AC_PN_English.pdf

Adugna Gebeye, B.: Corruption and Human Rights: Exploring the Relationships, 2012, f.9
<http://www.du.edu/korbel/hrhw/workingpapers/2012/70-gebeye-2012.pdf>

U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, National Institute of Justice "The Measurement of Police Integrity"
<file:///C:/Users/User/Desktop/Prison%20corruption.pdf>

Bassiouni Cherif, M., The protection of human rights in the Administration of Criminal Justice: A compendium of United Nations Norms and Standards, NY, 1994

Worley R., & Barua, V. (2009). Criminal Justice ethics. In J. Miller (Ed.). 21st Century criminology: A reference handbook. (pp 861-871). Thousand Oaks: Sage Publications, Inc. doi:10.4135/9781412971997.n98
http://www.sagepub.com/haganintrocrim8e/study/chapter/handbooks/42347_2.1.pdf

Aneks 1

Pyetësor drejtuar personave me liri të kufizuar (të paraburgosur dhe të dënuar) në IEVP

Ky pyetësor synon t'ju japë mundësinë për të vlerësuar situatën e respektimit të të drejtave tuaja në këtë institucion si edhe të evidentojë aspektet pozitive dhe ato ku duhet të punohet për t'i përmirësuar në të ardhmen. Të gjitha mendimet dhe sugjerimet tuaja vlerësohen maksimalisht, ndaj do t'ju luteshim të jeni sa më të hapur dhe objektivë në dhënien e mendimeve tuaja.

Të dhënat e marra nga pyetësori do të analizohen me qëllim identifikimin e problematikave dhe përmirësimin e pikave të dobëta ashtu sikurse do të nxjerrin në pah edhe aspektet që ju mund t'i vlerësoni si pozitive. Pyetësori do të shërbejë në përmirësimin e situatës në të ardhmen.

Organizatorët vlerësojnë pjesëmarrjen tuaj në këtë nismë, megjithatë plotësimi i këtij pyetësori nuk është i detyrueshëm. Pyetësori është tërësisht konfidencial dhe kërkon të marrë këndvështrimin, idetë e problematikat tuaja. Pasi të përpunohen të dhënat e pyetësorëve, të gjithë të dënuarit do të njihen me rezultatet e përgjithshme.

1. Kur keni ardhur në këtë institucion, me cilën nga situatat e mëposhtme jeni ndeshur:

- U njohët me të drejtat dhe detyrimet tuaja?
- Ju dha mundësia për të kontaktuar me familjarët tuaj?
- A ju dha mundësia të zgjidhnit se me kë do të donit ta ndanit dhomën?

Më poshtë janë disa deklaratat të bëra nga të burgosurit, mbi aspekte të ndryshme të jetës në burg. Ju lutemi shënoni kutinë përkatëse për të treguar nëse jeni dakord apo jo, nëse jeni plotësisht dakord apo të kundërtën:

Deklarata	Shumë dakord	Dakord	As po as jo	Kundër	Shumë kundër
Unë kam një Punonjës i Rolit Bazë/ Punonjës Social/ Edukator/ Psikolog si pikë kontakti.					
Punonjësi i Rolit Bazë / Punonjësi Social/ Edukatori/ Psikologu i nje kushtet dhe rrethanat e mia					
Do ti besoja Punonjësit të Rolit Bazë/ Punonjësit Social/ Edukatorit/ Psikologut në rast krize					
Shumica e Punonjësve të Rolit Bazë/ Punonjësit Social/ Edukatorit/ Psikologut të burgut janë të gatshëm për të ndihmuar					
Personeli i burgut dëgjon, merr dhe shqyrton sugjerimet dhe ankesat e të burgosurve					
Shumica e Punonjësve të Rolit Bazë / Punonjës Social/ Edukator/ Psikolog kontaktojnë me të burgosurit gjatë orëve të shërbimit					

E di që kur të më nevojitet do të mund të marr ndihmë profesionale (p.sh. nga avokatë, mjekë dhe psikologë)					
Mënyra në të cilën të burgosurve u shërbehen vaktet ushqyese është e respektueshme					
Kontrolli në qeli nuk prish rregullin në qeli					

Mundësi për t'u përfshirë në aktivitete/programe në institucion

2. A jeni të përfshirë aktualisht në ndonjë aktivitet punësimi apo programe të tjera brenda institucionit?

- po, në aktivitete/programe të ndryshme që organizohen në institucion
- po, në aktivitet pune brenda institucionit
- jo

3. Nëse jo dhe nëse do të donit ta bënit këtë, a keni dijeni mbi mundësitë që ekzistojnë për t'u përfshirë?

- po
- jo
- s`jam i/e sigurt

Konsultimi dhe përgjegjësitë

4. Deri në ç`shkallë ndjeni se keni mundësi të merrni përgjegjësi për aspektet e jetës suaj të përditshme brenda burgut?

- në një shkallë të konsiderueshme
- në një shkallë të vogël
- aspak

5. Sa shpesh ju shpjegohen vendimet e praktikës së përditshme që ndikojnë te ju?

- gjithmonë
- thuajse gjithmonë
- ndonjëherë
- rrallëherë ose asnjëherë

6. Në përgjithësi a pranohen arritjet/sukseset e arritura të të dënuarve dhe nëse po a vihen në pah ato nga personeli i institucionit?

- shpesh
- ndonjëherë
- rrallëherë
- kurrë

7. A është pranuar apo shpërblyer ndonjë nga arritjet tuaja në këtë burg?

- po
 jo

8. A jeni ndjerë nën presion për të dhënë para në këmbim të përfitimeve?

- po
 jo

Etika e komunikimit

9. Sa shpesh ju drejtohet personeli i burgut me të bërtitura dhe /ose në mënyra që ju duken fyese apo përçmuese?

- gjithmonë
 shpesh
 ndonjëherë
 me raste/rrallë
 asnjëherë

10. Vizitat në Burg

Studimet e mëparshme mes të burgosurve kanë treguar se trajtimi i vizitorëve dhe aspektet e vizitave janë veçanërisht të rëndësishme. Ju lutem, shënoni kutinë e duhur për të cilësuar nëse jeni dakord ose jo me deklaratat e mëposhtme mbi aspektet e ndryshme të vizitave:

Deklarata për trajtim pozitiv	Shumë dakord	Dakord	Asnjërin	Kundër	Shumë kundër
Sistemi i planifikimit të vizitave mund të përdoret me lehtësi (vendos vetë i dënuari për datat)					
Vizitorët mund të presin në rehati dhe intimitet të arsyeshëm					
Vizitorët e mi trajtohen me dinjitet gjatë kohës së takimeve					
Oficerët e burgut janë të ndjeshëm ndaj tensioneve/stresit të mundshëm gjatë vizitave për të burgosurin					
Do të prisja që kërkesat për mbledhjen e vizitave të priten mirë edhe në burgjet e tjera					
Deklarata për trajtime negative të vizitave	Shumë dakord	Dakord	Asnjërin	Kundër	Shumë kundër
Masat e sigurisë çënojnë intimitetin në mënyrë të panevojshme					
Vizitorët e mi shprehin ankesa për ngacmime seksuale gjatë vizitave, nga personeli i burgut.					